

Përmbledhje

- Ekonomia e eurozonës shënoi rritje reale prej 0.1 përqind në tremujorin e parë të vitit 2023, sipas Eurostat, rritje e ngadalësuar kjo që kryesisht i'u atribuua shkallës së lartë të inflacionit, rënies së aktivitetit industrial dhe përkeqësimit të perspektivës ekonomike botërore. Shkalla e inflacionit në TM1 2023 ka vazhduar trendin e rritjes duke arritur në 8.0 përqind, duke shtyrë BQE-në të rrisë normën bazë të interesit për herë të katërt brenda gjashtëmujorit të parë të vitit. Shkalla e inflacionit për vitin 2022 ishte 8.4 përqind, ndërsa projeksionet e BQE-së sugjerojnë një rënie të inflacionit në 5.4 përqind në 2023 dhe 3.0 përqind në vitin 2024. Ndërsa në TM1 2023, BPV-ja reale nga vendet e Ballkanit Perëndimor ka shënuar rritje të lehtë prej 2.8 përqind, e ndikuar nga ngadalësimi i rritjes ekonomike në eurozonë dhe rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare.
- **Rritja reale e Bruto Produktit Vendor (BPV) në Kosovë në TM1 2023 ishte më e lartë krahasuar me tremujorët paraprak të vitit 2022.** Vlerësimet e ASK-së sugjerojnë se Ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 3.9 përqind në TM1 2023. Konsumi privat, investimet si dhe eksporti i shërbimeve kontribuuan pozitivisht në rritjen reale ekonomike, ndërkaj ndikim negativ patën rënia e eksportit të mallrave dhe rritja e importit të shërbimeve. Rritje e ngjashme e aktivitetit ekonomike vlerësohet të ketë karakterizuar edhe TM2 2023. Investimet vlerësohet të kenë pasur një efekt pozitiv në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, ndërsa konsumi rritje të ngadalësuar, kryesisht për shkak të inflacionit të lartë. Edhe pse inflacioni është ulur ndjeshëm, ai vazhdon të mbetet i lartë, duke ndikuar negativisht në fuqinë blerëse të konsumatorëve.
- **Buxheti i Kosovës në TM1 2023 shënoi bilanc primar buxhetor pozitiv,** si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave buxhetore krahasuar me shpenzimet, ndërsa borxhi publik ra në 18.1 përqind të BPV-së, krahasuar me 20.3 përqind në TM1 2022. Përmirësimi i bilancit buxhetor të qeverisë dhe rritja e BPV-së nominale, që zvogëlon raportin e borxhit ndaj BPV-së, kryesisht ndikuan në rënien e nivelit të borgjit publik.
- **Presionet inflacioniste** u zbehën në TM1 2023 me normën e inflacionit të përgjithshëm që shënoi ngadalësim si rezultat i lehtësimeve në zinxhirët e furnizimit dhe çmimet e mallrave në tregjet ndërkombëtare, dhe ngadalësimit të konsumit në vend. Rritje e ngadalësuar u evidentua në pjesën më të madhe të komponentëve në shportën e konsumit, ndërsa çmimet e energjisë shënuan rënie në nivelet e tyre para fillimit të luftës në Ukrainë. Edhe inflacioni bazë shfaqti shenja të ngadalësimit në TM1 2023 pasi kishte shënuar normën më të lartë të rritjes në dhjetor 2022.
- **Logaria rrjedhëse** ka shënuar bilanc negativ prej 225.5 milionë euro në TM1 2023, dinamikë që kryesisht është përcaktuar nga zhvillimet në bilancin tregtar të mallrave. Bilanci i mallrave shënoi deficitin tregtar, ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që edhe bilanci i të ardhurave parësore shënoi bilanc negative duke zvogëluar të hyrat nga kjo kategori. Në anën tjetër, bilanci i shërbimeve dhe të hyrat dytësore ndikuan në tkurrjen e bilancit negativ të llogarisë rrjedhëse. Në kuadër të llogarisë rrjedhëse, një ndër burimet më të rëndësishme financuese të konsumit, remitanat, shënuan rritje prej 12.4 përqind, duke arritur në 271.3 milionë euro.
- **Sistemi financiar** është karakterizuar me qëndrueshmëri dhe pa ndonjë rrezik të materializuar pavarësisht luhatjeve në tregjet financiare ndërkombëtare si rezultat i dështimit të disa bankave të kategorisë së mesme në SHBA dhe një banke me rëndësi të përgjishme sistemike globale në Evropë.
 - **Sektori bankar** ka arritur të mbaj nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit si dhe të mirëmbajë nivel të ulët të kredive jo performuese. Krahasur me periudhën e njëjtë të një viti më parë, sektori bankar ka përmirësuar indiaktorët kryesor të shëndetit financiar, duke rritur kapacitetet e sektorit për të absorbuar goditjet potenciale në rast të krizave që mund të prodhohen (kryesisht nga jashtë). Në TM1 2023, aktiviteti kreditues ishte kontribuuesi kryesor në rritjen e aseteve të sistemit financiar, pasuar nga investimet në letrat me vlerë. Shtrëngimi i politikave monetare që nga viti i kaluar është reflektuar në rritje të normave të interesit në kredi dhe depozita edhe në tregun vendor. Rritja e normave të interesit në depozita ka nxitur rritjen e mjeteve të depozituara, me ç'rast norma e rritjes ishte në nivel rekord në 13 vitet e fundit, për të gjitha segmentët (depozitat e ekonomive familjare, korporatave jofinanciare, korporatave publike dhe korporatave tjera financiare).
 - **Sektori pensional** shënoi ngadalësim të rritjes dhe nivel më të ulët të kthimit bruto nga investimet krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar, kryesisht si pasojë e dinamikave jo të favorshme në tregjet financiare ndërkombëtare, megjithatë krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2022, performanca financiare e sektorit pensional ishte më e mirë. Të hyrat nga kontributdhënësit janë rritur krahasuar me tremujorin e njëjtë të një viti më parë dhe paraqesin burim stabil financues, veçanërisht në periudha kur sektori pensional rezulton me kthim negativ nga investimet (shkaktuar nga goditjet në ekonominë globale, e veçanërisht në sektorin financiar).
 - **Sektori i sigurimeve** u karakterizua me nivel të përafërt të rritjes së aseteve me vitin paraprak, të favorizuar nga niveli i lartë i primeve të arkëtuara. Dëmet e paguara gjatë kësaj periudhe ishin më të larta se një vit më parë, por rrija më e theksuar e primeve të arkëtuara ka ndikuar që sektori të përmirësoj tutje pozitën financiare krahasuar me vitin e kaluar.
 - Me rritje të përshpejtuar të aseteve u karakterizua **sektori mikrofinanciar**, atribuar kryesisht rritjes së aktivitetit kreditor dhe në masë më të ulët lizingjeve, që u financuan kryesisht nga huazimet prej sektorit të jashtëm (linjave kreditore). Indikatorët e shëndetit financiar gjithashtu tregojnë për stabilitet të sektorit në përgjithësi, ndërkohë që rezultati financiar ishte i ngjashëm me tremujorin e parë të vitit të kaluar, si rrjedhojë e rritjes më të lartë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat. Në periudhat në vijim, dinamikat e rritjes së normave të interesit në tregjet ndërkombëtare pritet të reflektohen në rritjen e kostove të financimit për sektorin mikrofinanciar.

Përmbajtja

Përmbledhje	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	2
Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare	3
Rritja Ekonomike	4
Çmimet	5
Sektori Fiskal	8
Sektori i jashtëm	9
Sistemi financiar	12
1. Sektori bankar	13
Kreditimi	14
1.1. Detyrimet dhe burimet vetanake	16
1.2 Normat e interesit	17
Sektori pensional	20
Sektori i sigurimeve	22
Sektori mikrofinanciar	23
Kreditë	24
Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës	27


Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia e eurozonës shënoi rritje reale prej 0.1 përqind në tremujorin e parë të vitit 2023, sipas Eurostat, rritje e ngadalësuar por pozitive - marrë parasysh pritjet për recesion të mundshëm. Shkalla e lartë e inflacionit, rënia e aktivitetet industrial dhe përkeqësimi i perspektivës ekonomike botërore ishin disa nga faktorët kryesor të dobësimit të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Ekonomia e eurozonës është ndikuar ndjeshëm nga rritja e dukshme të çmimeve të konsumit, dinamikë që u shoqërua me rënie të shpenzimeve të konsumit final të ekonomive familjare. Tutje, shtrëngimi i politikës monetare nga Banka Qendrore Evropiane, më i shpejti në mbi dy dekada, ka ndikuar në rënie e nivelit të besimit ndaj bizneseve dhe konsumatorëve. Në kuadër të ekonomive më të mëdha të eurozonës, Gjermania rezulton të ketë shënuar rënie të aktivitetit ekonomik prej 0.3 përqind, atribuar kryesisht rënies së konsumit familjar. **Projeksionet për rritje ekonomike në eurozonë nga BQE janë rishikuar për poshtë në qershor kundrejt projeksioneve të marsit, në 0.9 përqind për vitin 2023 dhe 1.5 përqind për vitin 2024.**

Shkalla e inflacionit në TM1 2023 ka vazhduar trendin e rritjes duke arritur në 8.0 përqind (6.1 përqind në TM1 2022), e ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimit. Në qershor 2023, për herë të katërt brenda gjashtëmujorit të parë të vitit, BQE procedoi me rritjen e tri normave kyçe të interesit të BQE-së: normën në depozita (në 3.5 përqind në qershor 2023), normën në operacione të rifinancimit (4.0 përqind në qershor 2023) dhe normën marginale për huadhënie (4.25 përqind). Për me tepër, rritja e normave të interesit do të vazhdoj edhe pjesën e dytë të vitit 2023, sipas ECB-së, deri në normalizimin e çmimeve dhe frenimin e inflacionit. **Shkalla e inflacionit për vitin 2022 ishte 8.4 përqind, ndërsa projeksionet e BQE-së sugjerojnë një rritje më të ngadalshme të çmimeve dhe shkallës së inflacionit në 5.4 përqind në 2023 dhe 3.0 përqind në vitin 2024.**

Ngadalësimi i rritjes ekonomike në eurozonë dhe rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare ndikuan dinamikat e përgjithshme ekonomike edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, reflektuar përmes presioneve të larta inflacioniste dhe dobësimit të kërkesës. Ne TM1 2023, BPV-ja reale nga vendet e rajonit shënuar rritje prej 2.8 përqind (4.7 përqind TM1 2022). Projeksionet e FMN-së sugjerojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor pritet të shënojnë rritje ekonomike prej 2.1 përqind në vitin 2023 dhe 3.2 përqind në 2024. Shkalla mesatare e inflacionit në TM1 2023 në vendet e rajonit rezulton të ketë qenë 12.3 përqind, me shkallën më të lartë të shënuar në Serbi prej 16.0 përqind dhe në Maqedoninë e Veriut prej 14.7 përqind, ndërsa Shqipëria shënoi normën më të ulët të inflacionit prej 6.5 përqind. Në përpjekje për të luftuar inflacionin në rritje, bankat qendrore në vendet e rajonit kanë vazhduar të rrisin normën bazë të interesit edhe në TM1 2023 (grafik 1).

Grafik 1. Vendet e Ballkanit Perëndimor (TM1 2023)



Burimi: BQK.


Në TM1 2023, tregu i këmbimit valutor i euros kundrejt valutave të partnerëve tregtar u vlerësua për ndaj sterlinës britanike dhe lirës turke. Vlera e valutës euro mbeti pothuajse e njëjtë ndaj dinarit serb dhe denarit maqedonas, ndërsa u zhvlerësua kundrejt lekut shqiptar dhe dollarit amerikan.

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare u lehtësuan në tremujorin e parë të vitit 2023, mbështetur nga ngadalësimi i rritjes ekonomike globale pas shtrëngimit të politikave monetare si dhe lehtësimi i vazhdueshëm i pengesave në zinxhirët e furnizimit. Megjithatë, çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare mbeten të larta krahasuar me nivelet e tyre para fillimit të krizës energjetike në 2021 dhe luftës në Ukrainë, dhe vazhdojnë të pasqyrohen në çmime të larta të konsumit.

Çmimet e naftës së papërpunuar brent sipas Bankës Botërore arritën në \$81.4 për fuçi në TM1 2023, duke shënuar rënie prej 17.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (\$99.0 për fuçi në TM1 2022) (grafik 2). Ndërsa, në raport me tremujorin paraprak, çmimet e naftës shënuan rënie prej 7.8 përqind (\$88.4 për fuçi në TM4 2022). Çmimet e naftës ishin relativisht stabile në dy muajt e parë të vitit 2023, ndërsa në mars ranë në nivelet e tyre të fundit të vitit 2021. Kjo rënie erdhi si rrjedhojë e ngadalësimit të

Grafik 2. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Banka Botërore.

kërkesës së përgjithshme pas shtrëngimit të politikave monetare dhe rritjes së shqetësimeve rreth sfidave të sektorit bankar në SHBA dhe implikimeve në tregjet financiare. Megjithatë, marrë parasysh pritjet për ngadalësim të kërkesës globale përgjatë vitit 2023 dhe ndikimin në çmimet e naftës, OPEC njoftoi për reduktimin e sasisë së prodhimit të naftës prej 1.7 milion fuçi në ditë nga muaji maj deri në fund të vitit 2023, që ndikoi në rritjen e çmimit të naftës në \$84.1 për fuçi në prill 2023, që përkon me nivelin e parashikuar nga Banka Botërore sa i përket çmimit të naftës brent për vitin 2023.


Çmimet e gazit natyror në Evropë vazhduan të bien gjatë TM1 2023 duke arritur nivelet e tyre në prag të fillimit të krizës energjetike nga mesi i vitit 2021. Në TM1 2023, çmimet e gazit natyror arritën mesatare tremujore prej \$16.8/mmbtu që përbën rënie prej 48.4 përqind krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (\$32.6/mmbtu në TM1 2022) (grafik 2). Po ashtu, çmimet e gazit natyror shënuan rënie prej 54.4 përqind kundrejt tremujorit paraprak kur kishin arritur mesatare tremujore prej \$36.9/mmbtu. Rënia e çmimeve të gazit natyror erdhi si rezultat i rritjes së importit të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) nga SHBA-të që ndihmoi në mbushjen e rezervave të gazit natyror në BE duke zbutur kështu shqetësimet rreth sigurisë së furnizimit gjatë dimrit. Për më shumë, përpjekjet e BE-së për rritje të efikasitetit dhe ruajtje të energjisë si dhe dimri i butë ndikuan dukshëm në zvogëlimin e kërkesës për përdorim të gazit natyror për ngrohje që rrjedhimisht u reflektua në rënie të çmimit të gazit natyror.

Çmimet e metaleve dhe mineraleve shënuan rënie prej 15.9 përqind krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak si rrjedhojë e ngadalësimit të kërkesës globale (grafik 3). Megjithatë, krahasuar me tremujorin paraprak çmimet e metaleve dhe mineraleve shënuan rritje prej 9.8 përqind nxitur nga pritjet e tregjeve për rritje të kërkesës për metale pas rihapjes së ekonomisë së Kinës, me sektorin e ndërtimit që pritej të kishte rimëkëmbje të fortë pas subvencionimeve për këtë sektor. Megjithatë, kërkesa e Kinës për metale nuk ishte aq e fortë sa pritej, dhe rrjedhimisht krahas ngadalësimit të kërkesës globale kjo ndikoi që çmimet e metaleve dhe

mineraleve të ndjekin trajektore rënese në mars 2023. Ngjashëm, çmimet e metaleve të çmuara shënuan rritje prej 8.6 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, duke arritur kështu nivelet e tyre në fillim të luftës në Ukrainë kur ishin shtuar pasiguritë, ndërsa në TM1 2023 pasiguritë u intensifikuan pas sfidave të sistemit bankar në SHBA si pasojë e rritjes së normave të interesit. Për më shumë, çmimet e metaleve të çmuara u rritën edhe nga dobësimi i dollarit amerikan dhe rritja e kërkesës për platin dhe argjend në industrinë automobilistike, elektronike, atë të energjisë, e të tjera.

Në TM1 2023, indeksi i çmimeve të ushqimit sipas FAO shënoi rënie relativisht të lehtë prej -3.7 përqind krahasuar me tremujorin paraprak (grafik 4). Ndërsa, kundrejt TM1 2022 çmimet e ushqimit shënuan rënie prej 11.3 përqind si rezultat i mbarëvajtjes së marrëveshjes mes Rusisë dhe Ukrainës për eksportin e drithërave nga Ukraina në tregjet ndërkombëtare, rendimentit më të lartë, dhe rënies së çmimeve të energjisë. Rrjedhimisht u shënuar rënie vjetore prej 36.2 përqind në çmimet e vajrave dhe 5.1 përqind në çmimet e drithërave, ndërsa edhe çmimet e bulmetit dhe mishit shënuan rënie vjetore prej 7.0 dhe 1.8 përqind respektivisht. Në anën tjetër, çmimet e sheqerit shënuan rritje vjetore prej 8.5 përqind si pasojë e reduktimit të ofertës globale, kushtet atmosferike që ndikuan negativisht në të korrurat në Brazil, si dhe vlerësimit të realit brazilian që ndikoi në rritjen e çmimit të eksporteve të sheqerit. Përkundër lehtësimeve në zinxhirët e furnizimit dhe çmimet e ushqimit në TM1 2023, shkelja e marrëveshjes nga ana e Rusisë në korrik 2023 rrezikon sigurinë e furnizimit me ushqim për vendet importuese të drithërave dhe vajrave nga Ukraina, si dhe rritjen e mëtejshme të çmimeve të këtyre produkteve dhe intensifikimin e presioneve inflacioniste në çmimet e mallrave tjera.

Grafik 3. Çmimet e metaleve dhe mineraleve dhe metaleve të çmuara



Burimi: Banka Botërore.


Ekonomia e Kosovës

Rritja Ekonomike

Aktiviteti ekonomik në Kosovë, sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shënoi një rritje reale prej 3.9 përqind në TM1 2023 (grafik 5). Kërkesa e brendshme dhe eksportet neto kontribuan pozitivisht në rritjen reale të BPV-së me 1.0 përkatesisht 2.9 pikë përqindje.

Konsumi kontriboi me 0.6 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së, duke shënuar një kontribut më të ulët krahasuar me tremujorët e


Grafik 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Burimi: FAO.

mëparshëm. Ngadalësimin e rritjes së konsumit e ka ndikuar kryesisht rënia e fuqisë blerëse të konsumatorëve, për shkak të rritjes së çmimeve, ndërkohë që burimet kryesore të financimit si remitencat, kreditë e reja konsumuese, konsumi publik, etj., shënuan rritje. Investimet gjithashtu kontribuuan pozitivisht me 0.4 pikë përqindje në rritjen e BPV-së reale, kryesisht si rezultat i rritjes së IHD-ve dhe investimeve publike. Për sa i përket tregtisë së jashtme, eksportet neto kontribuuan pozitivisht me 2.9 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së. Kontributi më i madh ka ardhur nga eksporti i mallrave dhe shërbimeve, i cili ka kontribuar pozitivisht me 4.8 pikë përqindje, ndërsa importi ka kontribuar negativisht me 1.9 pikë përqindje.

Grafik 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë




Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Rritja e aktivitetit ekonomik në TM1 2023 është mbështetur kryesisht nga rritja e vlerës së shtuar në sektorin e tregtisë (9.8 përqind), sektorin industrisë përpunuese (9.2 përqind), sektorin e aktiviteteve financiare dhe të sigurimit (7.4 përqind), etj. Të dhënat e qarkullimit të bizneseve konfirmojnë këtë rritje, ku qarkullimi në sektorin e tregtisë ka shënuar një rritje prej 10.1 përqind, ndërsa në sektorin e industrisë përpunuese është rritur me 7.6 përqind. Sektori i aktiviteteve financiare dhe të sigurimit ka shënuar një rritje të dukshme prej 22.3 përqind. Në kontrast, sektori i ndërtimitarisë, për shkak të rritjes së kostos së ndërtimit, pati një performancë të dobët gjatë vitit të kaluar. Megjithatë, në TM1 2023, me ngadalësimin e rritjes së kostos së ndërtimit, kjo industri ka shënuar një rritje të vlerës së shtuar prej 1.4 përqind dhe një rritje të qarkullimit prej 12.4 përqind.

Aktiviteti ekonomik u reflektua në rritjen e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara, që arriti në 3,086 ndërmarrje në TM1 2023, gjegjësisht 9.0 përqind më shumë krahasuar me TM1 2022. Sektori i tregtisë, prodhimit, ndërtimitarisë, aktiviteteve profesionale, hotelarisë dhe sektorë të tjerë regjistruan numër më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara (grafik 6). Këto sektorë treguan një rritje të ndjeshme në numrin e ndërmarrjeve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 (grafik 6). Në anën tjetër, gjatë TM1 2023, u mbyllën 446 ndërmarrje, që përfaqëson një zvogëlim prej 9.9 përqind krahasuar me TM1 2022.

Për sa i përket TM2 2023, vlerësohet të ketë ndodhur një rritje e ngjashme e aktivitetit ekonomik. **Vlerësimet e BQK-së sugjerojnë për një rritje reale ekonomike prej 4.0 përqind.** Kërkesa e brendshme vlerësohet si faktori kryesor që ka kontribuar në këtë rritje ekonomike gjatë këtij tremujori. Investimet vlerësohet të kenë pasur një efekt pozitiv në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, ndërsa konsumi rritje të ngadalësuar, kryesisht për shkak të inflacionit të lartë. Edhe pse inflacioni është ulur ndjeshëm, ai vazhdon të mbetet i lartë, duke ndikuar negativisht në fuqinë blerëse të konsumatorëve. Për sa i përket tregtisë së jashtme, vlerësohet se eksportet neto kanë pasur ndikim negativ në rritjen e aktivitetit ekonomik.

Grafik 6. Numri i ndërmarrjeve të reja




Burimi: ASK.

Çmimet

Shkalla vjetore e inflacionit në TM1 2023 u ngadalësua në 9.9 përqind nga 12.1 përqind sa ishte në tremujorin paraprak. Përveç efektit të bazës dhe ngadalësimit të rritjes së çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare, rritja më e ngadalshme e çmimeve në vend i atribuohet edhe ngadalësimit të konsumit në vend. Ndonëse u shënua rritje e ngadalësuar e çmimeve në pjesën më të madhe të komponentëve të shportës së konsumit, shkalla e inflacionit vazhdon të mbetet e lartë si pasojë e çmimeve të larta të ushqimit, mallrave jo-ushqimore dhe jo-energjetike dhe shërbimeve (grafik 7). Për dallim, ngadalësimi dhe eventualisht rënia e çmimit të naftës në mars 2023 ndikoi pozitivisht në frenimin e inflacionit.

Grafik 7. Kontributi i nëngrupeve përkatëse në IÇK



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Çmimet e ushqimit shënuan rritje vjetore prej 17.6 përqind në TM1 2023, që tregon për ngadalësim të rritjes së çmimeve të ushqimit kundrejt rritjes vjetore prej 20.5 përqind në tremujorin paraprak. Rritja më e lartë vjetore u evidentua në çmimet e qumështit, djathit dhe vezëve (24.6 përqind) kategori kjo që shënoi edhe rritje të peshës në shportën e konsumit për vitin 2023. Po ashtu, rritje e konsiderueshme u shënua edhe në çmimet e bukës dhe drithërave (17.9 përqind), mishit (17.7 përqind), sheqerit, reçelit, mjaltës, çokollatave dhe ëmbëlsirave (17.2 përqind), vajrave dhe yndyrave (17.0 përqind), e të tjera.

Çmimet e energjisë elektrike dhe lëndëve tjera djegëse në kuadër të kategorisë së strehimit shënuan rritje mesatare vjetore prej 14.4 përqind në TM1 2023, mirëpo u ngadalësuan krahasuar me tremujorin paraprak (18.4 përqind në TM4 2022) si rezultat i dimrit të butë dhe ngadalësimit të çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare. Ngjashëm, çmimet e transportit shënuan rritje vjetore prej 6.0 përqind në TM1 2023 (10.9 përqind në TM4 2022), me nënkategorinë e përdorimit të pajisjeve për transport personal që regjistroi rritje të ngadalësuar prej 4.1 përqind kundrejt 15.6 përqind në TM4 2022, si rrjedhojë e rënies së çmimeve të karburanteve në tregjet ndërkombëtare. Rritja më e lartë vjetore në kuadër të kategorisë së transportit u shënua në çmimet e shërbimeve të transportit (15.1 përqind).


Kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit në TM1 2023 ishte 5.9 pikë përqindje, me kontributin më të lartë të shënuar nga rritja e çmimeve të qumështit, djathit dhe vezëve prej 2.0 pikë përqindje, bukës dhe drithërave prej 1.5 pikë përqindje, mishit prej 1.4 pikë përqindje, e të tjera. Ndërsa, kontributi i transportit në inflacionin e përgjithshëm në TM1 2023 ishte 1.0 pikë përqindje (ngadalësim nga 1.7 pikë përqindje në TM4 2022), me 0.4 pikë përqindje kontribut nga nënkategoria përdorimi i pajisjeve për transportin personal ku përfshihet pjesa më e madhe e karburanteve. Rritje u shënua edhe në kontributin e blerjes së automjeteve dhe shërbimeve të transportit ku në TM1 2023 kontributi i të dy kategorive ishte nga 0.3 pikë përqindje.

Ndërsa, kontributi i çmimeve të mallrave shënoi rritje prej 0.1 pikë përqindje duke arritur në 1.3 pikë përqindje në TM1 2023 krahasuar me tremujorin paraprak kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të pijeve alkoolike dhe duhanit. Megjithatë, në mars u evidentua ngadalësim i kontributit të çmimeve të mallrave në 1.2 pikë përqindje falë zvogëlimit të kontributit të të gjitha kategorive të mallrave me përjashtim të kontributit të pijeve

alkoolike dhe duhanit që mbeti pothuajse i pandryshuar. Kontributi mesatar tremujor i shërbimeve në gjithsej IÇK-në mbeti i pandryshuar kundrejt tremujorit paraprak (1.4 pikë përqindje) mirëpo në terma mujorë u evidentua rënie edhe në kontributin e shërbimeve që u ngadalësua në 1.2 pikë përqindje në mars 2023. Ky ngadalësim në kontributin e mallrave dhe shërbimeve erdhi si rezultat i ngadalësimit të çmimeve të shërbimeve të transportit dhe atyre hoteliere dhe të akomodimit në mars.

Inflacioni bazë në TM1 2023 shënoi rritje vjetore prej 5.9 përqind, që kundrejt tremujorit paraprak paraqet përshpejtim prej 0.2 pikë përqindje (grafik 8). Në pjesë të madhe kontributi në inflacionin bazë u shënuar nga kategoria 'orendi, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të shtëpisë' me 1.6 pikë përqindje dhe nga kategoria 'shërbime të transportit' me 1.5 pikë përqindje. Sidoqoftë, inflacioni bazë është duke ndjekur trend rënës, megjithëse me ritëm të ngadalshëm, duke u ngadalësuar në 5.1 përqind në mars 2023 pasi arriti kulmin prej 6.8 përqind në dhjetor 2022.


Grafik 8. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike, si dhe shkalla e lartë e pjesëmarrjes së këtyre mallrave në shportën e konsumit, ndikojnë që shkalla e inflacionit në Kosovë të përcaktohet në masë të madhe nga çmimet e mallrave të importuara. Në TM1 2023, 8.3 pikë përqindje të inflacionit në Kosovë ishte importuar, ndërsa 1.6 pikë përqindje u gjenerua nga presionet e brendshme inflacioniste (grafik 9). Si rezultat i lehtësimeve të vazhdueshme të çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, inflacioni i importuar në TM1 2023 tregon për ngadalësim kundrejt tremujorit paraprak, që po ashtu u pasqyrua pjesërisht në frenimin e inflacionit të brendshëm.

Grafik 9. Inflacioni i brendshëm dhe i importuar



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Luhatjet e çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare, të pasqyruara në Kosovë përmes çmimeve të mallrave të importuara, përmbledhen përmes indeksit të çmimeve të importit (IÇIMP) i cili në TM1 2023 shënoi rritje vjetore prej 8.7 përqind, që paraqet ngadalësim kundrejt rritjes vjetore prej 13.1 përqind në TM4 2022. Krahasuar me TM1 2022, kategoritë me peshën më të lartë në kuadër të këtij indeksi që përfshijnë i) artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhanin, ii) produktet minerale, iii) metalet bazë dhe artikujt përkatës, dhe iv) pajisjet e makinerisë dhe ato elektrike shënuan rritje vjetore prej 7.8 përqind, 12.8 përqind, -1.3 përqind,

dhe 5.7 përqind respektivisht. Ndërsa, në raport me tremujorin paraprak, IÇIMP shënoi rritje prej 1.1 përqind, si pasojë e përsheptimit të çmimeve të i) produkteve bimore, ii) artikujve ushqimorë të përgatitur, pijeve dhe duhanit, iii) pajisjeve të makinerisë dhe pajisjeve elektrike, iv) mjeteve të transportit, e të tjera.

Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) rezultoi në rënie prej 0.1 përqind në TM1 2023 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak si rezultat i rënies së çmimit të prodhimit të i) energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (14.8 përqind rënie vjetore), ii) metaleve (-2.5 përqind), prodhimit të iii) produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-3.1 përqind), si dhe ngadalësimit të çmimeve të komponentëve tjerë me peshë të konsiderueshme në IÇP si prodhimi i produkteve minerale jometalike dhe i produkteve të gomës dhe plastikës. Krahasuar me tremujorin paraprak IÇP rezultoi me rritje prej 3.2 përqind kryesisht si pasojë e rritjes ndonëse të ngadalësuar të çmimit të prodhimit të produkteve minerale jometalike dhe përsheptimit të çmimeve të i) prodhimit në xeherore dhe gurore, ii) përpunimit të produkteve ushqimore, iii) prodhimit të pijeve, e të tjera.

Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN) shënoi rritje vjetore prej 3.3 përqind në TM1 2023, nxitur nga rritja e çmimeve të transportit (16.4 përqind rritje vjetore), makinerive (11.1 përqind), kostove tjera me rritje vjetore prej 10.1 përqind, e të tjera. Në anën tjetër, përsheptimi i këtij indeksi në TM1 2023 u neutralizua pjesërisht nga rënia vjetore e çmimeve të energjisë prej 14.9 përqind. Kurse, në raport me tremujorin paraprak u vërejt rënie e IKN prej 1.3 përqind kryesisht si rezultat i rënies së çmimeve të transportit, materialeve ndërtimore dhe elektrike, dhe pagave.

Lidhur me perspektivën e inflacionit në Kosovë, BQK parashikon që inflacioni në TM3 2023 të ngadalësohet në 2.7 përqind, dhe për vitin 2023 në 4.8 përqind. Faktorët që pritet të kontribuojnë në këto dinamika përfshijnë lehtësimet e vazhdueshme të pengesave në zinxhirët e furnizimit, trendin zbritës të inflacionit në eurozonë, transmetimin e shtrëngimit të kushteve të financimit në kërkesën e brendshme, e të tjera. Sidoqoftë, rreziqet e ndërlydhura me inflacionin anojnë nga kahu i lartë dhe kryesisht përbëhen nga rreziqet për pengesa të reja në zinxhirët e furnizimit si pasojë e luftës në Ukrainë, rritje të çmimeve të ushqimit pas shkeljes së marrëveshjes nga ana e Rusisë për eksport të drithërave nga Ukraina, rritje të çmimit të naftës në tregjet e huaja dhe zvogëlim të sasisë së prodhimit nga OPEC+, zhvendosje të pritjeve për inflacionin, presione për rritje të pagave, e të tjera. Sa u përket pritjeve të bankave për inflacion vjetor në Kosovë për vitin 2023, këto janë ulur në 5.4 përqind në qershor nga pritjet për inflacion vjetor prej 6.4 përqind në mars 2023.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore¹ në TM1 2023 arritën vlerën neto prej 658.5 milionë euro, duke paraqitur një rritje vjetore prej 21.4 përqind. Rritja e të hyrave buxhetore ishte kryesisht rezultat i normës së lartë të inflacionit, i cili u reflektua kryesisht te tatimet indirekte, si kategoria kryesore e të hyrave buxhetore. **Gjithashtu, shpenzimet buxhetore² shënuan rritje prej 14.4 përqind dhe arritën vlerën prej 489.9 milionë euro. Rrjedhimisht, Buxheti i Kosovës regjistroi bilanc pozitiv buxhetor prej 168.5 milionë euro.**


Të hyrat tatimore arritën vlerën prej 534.1 milionë euro, ose 10.7 përqind më shumë krahasuar me TM1 2022. Në kuadër të të hyrave tatimore, pothuajse të gjitha kategoritë shënuan rritje. Rritja më e lartë është regjistruar te të hyrat tatimore direkte, që arritën vlerën prej 116.8 milionë euro apo 16.8 përqind më shumë krahasuar me TM1 2022. Në këtë kategori, tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore, shënoi rritje vjetore prej 23.1 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje vjetore prej 11.7 përqind. Të hyrat tatimore indirekte shënuan rritje prej 10.2 përqind dhe arritën vlerën 433.1 milionë euro. Në

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore përfshihet edhe granti i BE-së për energjinë në vlerë prej 67.5 milionë euro, ndërsa nuk përfshihen pranimet nga financimi si dhe pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim si dhe pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

kuadër të tatimeve indirekte, të hyrat nga TVSH-ja dhe detyrimi doganor shënuan rritje prej 14.1 përkatësisht 16.4 përqind duke u ndikuar dukshëm nga rritja e çmimeve. Ndërsa, si rezultat i rënies së sasisë së importit, të hyrat nga akciza shënuan një rënie të lehtë prej 0.8 përqind (grafik 10). Për dallim nga të hyrat tatimore, **të hyrat jo-tatimore shënuan rënie prej 5.6 përqind dhe arritën vlerën 56.9 milionë euro.** Në kuadër të të hyrave jo-tatimore, të hyrat nga qeveria qendrore arritën vlerën prej 30.4 milionë euro duke shënuar rënie prej 22.9 përqind, ndërsa të hyrat nga qeveria lokale shënuan rritje për 35.3 përqind dhe arritën vlerën prej 14.9 milionë euro.

Grafik 10. Struktura e të hyrave tatimore




Burimi: MFPT dhe kalkulimet e BQK-së.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje prej 14.4 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale shënuan rritje prej 44.6 përqind. Në kategorinë e shpenzimeve rrjedhëse, subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 21.2 përqind dhe arritën vlerën prej 207.4 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për paga shënuan rritje për 10.2 përqind dhe arritën vlerën prej 181.0 milionë euro, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) shënuan rënie për 5.9 përqind dhe arritën vlerën 61.1 milionë euro. Shpenzimet kapitale shënuan rritje prej 44.6 përqind duke arritur vlerën prej 40.5 milionë euro.

Raporti i borxhit ndaj BPV-së ishte 18.1 përqind në TM1 2023, krahasuar me 20.3 përqind në TM1 2022. Kjo ulje ishte si rezultat i përmirësimit të bilancit buxhetor të qeverisë dhe rritjes së BPV-së nominale, e cila zvogëlon raportin e borxhit ndaj BPV-së. Ky nivel i borxhit publik është larg nga pragu i paraparë me ligj prej 40 përqind e BPV-së si dhe larg nga mesatarja e vendeve të rajonit që është rreth 60 përqind e BPV-së. Megjithatë, në terma absolut, borxhi publik ka arritur në 1.76 miliardë euro në TM1 2023, duke u rritur për 4.7 përqind krahasuar me TM1 2022. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të jashtëm publik për 14.9 përqind, duke arritur në 644.8 milionë euro, ndërsa borxhi i brendshëm publik shënoi rënie prej 0.5 përqind dhe arriti në 1.1 miliardë euro. Borxhi i jashtëm përbëhet nga detyrimet ndaj Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (34 përqind), Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (15 përqind), Fondit Monetar Ndërkombëtar (8 përqind), etj. Ndërsa, borxhi i brendshëm përbëhet kryesisht nga borxhi i Qeverisë së Kosovës ndaj fondeve pensionale (49 përqind), bankave komerciale (24 përqind), institucioneve publike (20 përqind), etj.

Grafik 11. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK.

Sektori i jashtëm

Llogaria rrjedhëse në TM1 2023 ka shënuar rënie vjetore të bilancit negativ për 26.7 përqind, dhe arriti në 225.5 milionë euro. Dinamikat në

llogarinë rrjedhëse në tremujorin e parë të vitit 2023 ka vazhduar të përcaktohet kryesisht nga zhvillimet e bilancit tregtar të mallrave (grafik 11). Në kuadër të llogarisë rrjedhëse, të ardhurat parësore kanë shënuar


bilanc negativ, ndërkohë që të ardhurat dytësore dhe shërbimet ndikuan në zvogëlimin e bilancit negativ të llogarisë rrjedhëse.

Bilanci tregtar i mallrave në Kosovë në tremujorin e parë ka shënuar rritje vjetore të deficitit tregtar prej 0.7 përqind, duke arritur në 1.04 miliard euro. Arsyeja kryesore e rritjes së deficitit tregtar ndërlidhet nga vlera e lartë e importit të mallrave, dinamikë që kryesisht është ndikuar nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Ekonomia e Kosovës rezulton të ketë importuar në vlerë prej 1.25 miliard euro, deri sa po në të njëjtën periudhë, është eksportuar në vlerë prej 217.1 milionë euro (grafik 12). Eksportet kanë mbuluar vetëm 17.3 përqind të importeve, respektivisht 1:5.7 raporti tregtar. Shkalla e lartë e deficitit tregtar rritë ndjeshmërinë ndaj dinamikave në tregjet ndërkombëtare.

Vlera e përgjithshme e eksportit në TM1 2023 ishte 217.1 milionë euro, një rënie e lehtë prej 0.1 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rënia e lehtë e eksporteve u ndikua kryesisht nga eksporti i produkteve të metaleve bazë, që shënuan rënie prej 18.7 përqind dhe shënuan vlerën prej 42.2 milionë euro, rënie që kryesisht i atribuohet dobësimit të kërkesës së jashtme si pasojë e çmimeve të larta të metaleve. Në rënien e eksportit ndikoi edhe kategoria e artikujt tjerë të prodhuar, kategori që shënoi rënie prej 56.5 përqind dhe kishte vlerën prej 25.2 milionë euro. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në TM1 2023 janë: Ballkani Perëndimor prej 39.3 përqind, dhe vendet BE-së prej 32.9 përqind e gjithsej mallrave të eksportuara. Struktura e mallrave sipas kategorive mbetet e pa ndryshuar, ekonomia e Kosovës eksporti metale bazë të destinuara kryesisht në vendet e rajonit, e ndjekur nga kategoria e produkteve të plastikës përfshirë gomës dhe mineraleve të eksportuara kryesisht në vendet e BE-së (grafik 13).


Vlera e importit të mallrave në TM1 2023 arriti në 1.25 miliard euro, një rritje vjetore prej 0.5 përqind. Rritja e lehtë e importit të mallrave u ndikua nga sasia dhe pesha e përgjithshme, duke shënuar rritje vjetore

Grafik 12. Bilanci tregtar i mallrave




Burimi: ASK.

Garfik 13. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK.

Garfik 14. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro




Burimi: BQK.

prej 1.8 dhe 6.9 përqind, ndikuar si nga rënia e çmimeve të produkteve minerale (80.2 milionë euro më pak nga kategoria e importit të produkteve minerale), ashtu edhe nga dobësimi i kërkesës së përgjithshme në vend. Struktura e kategorive të mallrave të importuara vazhdon të dominohet nga importi i produkteve minerale, makineritë përfshirë pajisjet shtëpiak dhe artikujt ushqimorë. Pjesëmarrja sipas kategorive kryesore të importit u dominua nga kategoria e mallrave të ndërmjetme prej 47.9 përqind, mallrat konsumuese 33.3 përqind, ndërsa kategoria e mallrave kapitale mbetet e ulët prej 10.3 përqind e importit të përgjithshëm (grafik 14). Sipas kategorive kryesore ekonomike, mallrat e ndërmjetme shënuan rënie prej 14.0 përqind, ndikuar kryesisht nga dinamikat e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe dobësimi i kërkesës në vend, ndërsa kategoria e mallrave kapitale dhe konsumuese shënuan rritje vjetore prej 14.3 dhe 14.7 përqind, kryesisht si rezultat i presioneve inflacioniste. Rreth 43.9 përqind e importeve të mallrave ka ardhur nga vende të Bashkimit Evropian (550.6 milionë euro), ndër të cilat peshën kryesore vazhdon ta ketë Gjermania me 12.2 përqind të gjithsej importeve. Nga vendet e rajonit, Kosova importoi 16.7 përqind të importit të përgjithshëm apo 208.8 milionë euro. Ndërkohë, importi i mallrave nga Turqia ka arritur shumë prej 180.3 milionë euro apo 14.4 përqind e gjithsej importeve.


Shërbimet kanë vazhduar të rrisin kontributin pozitiv në kuadër të llogarisë rrjedhëse, me një rritje vjetore të bilancit pozitiv prej 50.6 përqind dhe arritur vlerën prej 261.0 milionë euro në TM1 2023. Eksporti i shërbimeve i'u atribua kryesisht rritjes së shërbimeve në kategorinë e udhëtimit prej 20.8 përqind, kategori që arriti vlerën prej 330.5 milionë euro (grafik 15). Eksporti i shërbimeve kompjuterike rezultoi të ketë shënuar rritje prej 56.9 përqind, duke shënuar vlerën 57.9 milionë euro. Në anën tjetër, rritja e importit të shërbimeve i'u atribua rritjes së komponentëve së udhëtimit dhe transportit, e që përbejnë 60.9 përqind e përgjithshme e importit të shërbimeve.

Grafik 15. Bilanci i shërbimeve




Burimi: BQK.

Grafik 16. Bilanci i të ardhurave parësore



Burimi: BQK.

Grafik 17. Remitancat




Burimi: BQK.

Burimi: BQK. Eksporti i shërbimeve i'u atribua kryesisht rritjes së shërbimeve në kategorinë e udhëtimit prej 20.8 përqind, kategori që arriti vlerën prej 330.5 milionë euro (grafik 15). Eksporti i shërbimeve kompjuterike rezultoi të ketë shënuar rritje prej 56.9 përqind, duke shënuar vlerën 57.9 milionë euro. Në anën tjetër, rritja e importit të shërbimeve i'u atribua rritjes së komponentëve së udhëtimit dhe transportit, e që përbejnë 60.9 përqind e përgjithshme e importit të shërbimeve.

Bilanci i të ardhurave parësore shënoi rënie prej 90.7 përqind, duke arritur vlerën prej 7.2 milionë euro (77.4 milionë euro TM1 2022). Rënia e të ardhurave parësore u ndikua kryesisht nga bilanci i të ardhurave nga investimet, si pasojë e kthimit të dividendes në vlerë prej 64.5 milionë euro nga investimet direkte. Ndërsa, bilanci i të ardhurave nga kompensimi i punëtorëve ka shënuar rritje prej 2.7 përqind, e ndikuar nga rritja e të hyrave nga punëtorët rezident jashtë vendit (grafik 16).

Grafik 18. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

Vlera e remitencave të pranuar në TM1 2023 ka arritur në 271.3 milionë euro, rritje prej 12.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Struktura e remitencave sipas shteteve mbetet e pa ndryshuar: Gjermania që ka një pjesëmarrje prej 38.8 përqind e remitencave të dërguara, Zvicra 17.2 përqind dhe SHBA-të 7.6 përqind. Dërgesat e emigranteve sipas kanaleve formale (bankat dhe institucione tjerat) kanë shënuar rritje në vlerë prej 19.8 milionë euro, ndërsa është shënuar rritje e lehtë e dërgesave në kanale jo formale. Duke konsideruar që pjesa me e madhe e remitencave të pranuar origjinojnë nga vendet e eurozonës (57.2 përqind), ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në eurozonë mund të ketë implikime mbi këtë të hyrë për ekonominë e Kosovës.


Investimet e huaja direkte në TM1 2023 rezultojnë të kenë shënuar rritje prej 62.8 përqind, duke arritur vlerën prej 189.8 milionë euro. Rritja e IHD-ve është evidentuar kryesisht në sektorët patundshmërisë, sektorin financiar dhe të sigurimit. Sektori i patundshmërisë mbulon 55.5 përqind e përgjithshme të IHD-ve apo 105.3 milionë euro. Rritja e vlerës së IHD-ve në sektorin e patundshmërisë vlerësohet se u ndikua kryesisht nga rritja e çmimeve në këtë sektor. Investimet e huaja direkte të rezidentëve nga Kosova në vendet tjera kanë shënuar rritje të lartë në TM1 2023, duke arritur vlerën prej 49.1 milionë euro (31.2 milionë euro në TM1 2022), investime të destinuar në vendet e rajonit e të orientuara kryesisht në sektorin e patundshmërisë (grafik 18).

Sistemi financiar

Përkundër sfidave nga rreziqet më të larta me të cilat u përballë ekonomia, si inflacioni i rritur dhe perspektiva më e dobët ekonomike, sistemi financiar në vend është zgjeruar me ritëm të përshpejtuar.

Asetet e sistemit financiar në vend përshpejtuan rritjen vjetore për 4.4 pikë përqindje kundrejt një viti më parë, dhe vlera e tyre arriti në 9.98 miliardë euro në fund të marsit 2023. Rritja e përshpejtuar u ndikua kryesisht nga ecuria e sektorit bankar, përderisa sektorët tjerë kishin kontribut më të ulët në rritjen e gjithsej aseteve të sistemit financiar (grafik 19).

Grafik 19. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës




Burimi: BQK.

Sektori bankar në mars 2023 përfaqësoi 67.8 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, duke dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e gjithsej aseteve të sistemit (grafik 20). Sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, fondet pensionale, shënuan rritje më të ngadalësuar të aseteve krahasuar me një vit më parë (grafik 20). Ndërsa sektorët tjerë, ai mikrofinanciar, i sigurimeve dhe ndihmësve financiar shënuan rritje dyshifrore të aktivitetit duke kontribuar dukshëm në gjithsej asete e sistemit financiar, përkundër peshës së ulët përbërëse që kanë.

1. Sektori bankar

Sektori bankar dhe sistemi financiar në përgjithësi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të jashtme si rezultat i tensioneve gjeopolitike që mund të përshkallëzohen në Evropën Lindore, kurse inflacioni mbetet rreziku kryesor. Përkundër që situatat që e kanë nxitur inflacionin janë zbutur dhe politikat monetare të bankave qendrore janë duke prodhuar efekt, pasojat e inflacionit të transmetuara në segmentet tjera janë ende aktuale, inflacioni është persistent (i qëndrueshëm) dhe me rënie të ngadalshme. Sektori bankar në Kosovë për shkak të peshës, strukturë dhe kompleksitetit të ulët nuk ka ekspozim të lartë me sektorin e jashtëm dhe pasojat potenciale të ndonjë krize apo paniku në sektorin financiar nuk do të rrezikojnë sektorin bankar në mënyrë direkte. Kurse, efektet negative që burojnë nga inflacioni kanë impakt më të drejtpërdrejt në tregun bankar vendor, dhe duhet të monitorohen indikatorët kryesor të shëndetit bankar.

Grafik 20. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje



Burimi: BQK.

Asetet

Asetet e sektorit bankar në mars 2023 arritën vlerën 6.77 miliardë euro, që përkon me rritje të përshpejtuar vjetore prej 16.2 përqind krahasuar me rritjen 6.9 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 21). Kontributin kryesor në rritje e kishte zgjerimi i kreditimit si aktiviteti kryesor i sektorit bankar. Investimi në letrat me vlerë ishte komponenta e dytë që kontriboi në përshpejtimin e rritjes së aseteve, pasuar nga kategoria e mjeteve të mbajtura në bankat tjera. Të dy këto kategori të fundit shënuan rritje të përshpejtuar krahasuar me rënie vjetore në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kurse, zëri i parasë së gatshme dhe bilanci me BQK-në ruajti nivelin e njëjtë të rritjes vjetore prej rreth 5.3 përqind, dhe ka peshë prej 11.0 përqind në gjithsej asetete e sektorit bankar.


Kreditimi

Aktiviteti kreditues i sektorit shënoi rritje vjetore prej 14.8 përqind, që përkon me një shkallë më të ulët të rritjes krahasuar me një vit më parë prej 18.4 përqind. Sipas Anketës së Kreditimit bankar, dinamikat e kreditimit në tremujorin e parë të vitit 2023 u ndikuan kryesisht nga kërkesat kreditore, pasi që oferta kreditore kishin ndryshime marginale pozitive përgjatë TM1 2023. Këto zhvillime ishin të ngjashme si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare. Zhvillime të ngjashme me tremujorin aktual pritet edhe për TM2 2023, ku kërkesa pritet të jetë shtytësi kryesor i aktivitetit kreditor.

Segmenti i korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore të stokut të kredive prej 13.8 përqind, që përkon me ngadalësim vjetor për 3.3 pikë përqindje (grafik 22). Ndërsa, kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 16.1 përqind, që në krahasim me vitin paraprak paraqet poashtu ngadalësim të rritjes, për 3.7 pikë përqindje. Për shkak të peshës më të lartë në gjithsej kreditë, segmenti i korporatave jofinanciare kishte kontributin më të lartë në rritjen prej 14.8 përqind të kreditimit të sektorit bankar (grafik 23).


Kreditë e reja në tremujorin e parë të vitit 2023 shënuan rënie vjetore për 3.6 përqind (rritje për 47.6 përqind në tremujori e parë 2022). Rritja e lartë e kredive

Grafik 21. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet




Burimi: BQK.

Grafik 22. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Grafik 23. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje



Burimi: BQK.


të reja në tremujorin e parë të vitit 2022 kishte reflektuar bazën e ulët të tyre në vitin 2021 (ndikuar nga masat kufizuese pandemike në atë periudhë), pasi që pandemi në vend u shfaq në gjysmën e dytë të muajit mars 2020, duke pasur ndikim të limituar në ecurinë e kredive të reja në tremujorin e parë të vitit 2020. Andaj, niveli i kredive të lëshuara gjatë tremujorëve të parë vitit 2023 dhe 2022 reflekton kapacitetet reale absorbuese të tregut vendor - zgjerimit përmes kreditimit, dhe jo domosdoshmërisht politikave lehtësuese të bankave (ofertës kreditore) apo kërkesës së madhe nga sektori real.

Të dy segmentet e sektorit privat shënuan rënie vjetore të kredive të reja gjatë tremujorit të parë të vitit 2023. Kreditë e reja për segmentin e ekonomive familjare shënuan rënie më të lartë, por korporatat jofinanciare kishin kontributin më të lartë në rënieën e përgjithshme prej 3.6 përqind të kredive të reja të sektorit bankar (grafik 24).

Deri në mars 2023, kreditë e reja të korporatave jofinanciare u zvogëluan për 3.4 përqind. Rënie shënuan kreditë me karakter investuese prej 3.9 përqind, kurse kreditë me karakteri jo-investues shënuan rritje vjetore prej 4.6 përqind. Kreditë e reja për ekonomitë familjare shënuan rënie prej 3.7 përqind përgjatë tremujorit të parë. Kreditë e reja konsumuese shënuan rritje vjetore prej 5.9 përqind nga rritja 3.8 përqind në tremujorin e parë të vitit 2022, ndërsa kreditë e reja hipotekare shënuan rënie vjetore prej 22.8 përqind, për herë të parë në 11 vitet e fundit, për periudhën raportuese (janar-mars). Po ashtu, krahasuar me tremujorin e parë të viti të kaluar, kemi rënie edhe të investimeve të huaja direkte në segmentin e patundshmërive (në 105.3 milionë euro në TM1 2023 nga 111.7 milionë euro në TM1 2022). Për më tepër, edhe komponenti i ndërtimitarisë në kuadër të Bruto Produktit Vendor (BPV-së) për tremujorin e parë të vitit 2023, shënoi rritje reale më të ngadalësuar, për 1.37 përqind (3.04 përqind në TM1 2022).


Në kuadër të kredive për korporatat jo financiare, sektori i tregtisë është më i kredituari ndër vite, pasuar nga ai i prodhimitarisë dhe i ndërtimitarisë, të cilët janë zgjeruar gradualisht në vitet e fundit duke rritur pjesëmarrjen në gjithësej kreditë e sektorit bankar. Në fund të marsit 2023, kreditimi ndaj sektorit të tregtisë kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithësej kredive për segmentin e korporatave jofinanciare (grafik 25), si rezultat i rritjes vjetore prej

Grafik 24. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 25. Kontributi në rritjen e gjithësej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK.

Grafik 26. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK.

12.8 përqind (grafik 26). Sektori i prodhimitarisë, që në vitin e kaluar kishte peshën më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit për këtë segment, në mars 2023 shënoi rritje më të ngadalësuar vjetore prej 18.3 përqind nga 47.1 përqind një vit më parë. Kreditimi ndaj sektorit të ndërtimitarisë shënoi rritje vjetore dukshëm më të ngadalësuar kundrejt tregtisë dhe veçanërisht prodhimitarisë, prej 9.3 përqind në mars 2023, nga 19.4 përqind një vit më parë. Në ngadalësimin e kreditimit për këtë sektor mund të ketë ndikuar edhe shkalla e lartë e inflacionit në vitin 2022 – rritjes së çmimit të materialeve ndërtimore që janë transmetuar në ngadalësimin e punimeve ndërtimore apo ndërprerjen e përkohshme të tyre, por që kanë treguar tendencë rënëse (çmimet në ndërtimtari) në këtë tremujor. Sektori i bujqësisë, i cili është më së paku i kredituar nga bankat komerciale, u karakterizua me rritje pozitive prej 14.2 përqind, për dallim nga rënia e theksuar në vitin paraprak prej 13.7 përqind.

1.1. Detyrimet dhe burimet vetanake


Financimi i aktiviteteve të sektorit bankar vazhdoi të mbështetet në depozitat e klientëve dhe kapitalit vetanak, konkretisht fitimit të mbajtur nga periudhat paraprake dhe fitimit të realizuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2023. Të dy këto zëra përbëjnë rreth 93.1 përqind të detyrimeve dhe ekuitetit, ku 82.2 përqind përbëhen vetëm nga depozitat. Shtrengimi i politikave monetare në nivel global që ka ndikuar në rritjen e përgjithshme të normave të interesit, e reflektuar edhe në tregun vendor që nga gjysma e dytë të vitit 2022, u shoqërua me rritje të përforcuar të vlerës së gjithsej depozitave.

1.1.1 Depozitat

Vlera e stokut të depozitave në fund të marsit 2023 arriti në 5.56 miliardë euro (grafik 27), që paraqet një rritje vjetore të përsheptuar prej 17.1 përqind, nga 7.3 përqind në mars të vitit 2022. Depozitat e dy segmenteve të sektorit privat shënuan përsheptim të rritjes dhe përcaktuan trendin e rritjes të gjithsej depozitave. Për më tepër, edhe depozitat e arkëtuara prej korporatave publike dhe fondeve pensionale shënuan rritje të theksuar, duke kontribuar në normën më të lartë të rritjes në 13 vitet e fundit.


Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 11.8 përqind në mars 2023 nga 10.5 përqind në vitin paraprak, zhvillim ky që është ndikuar nga rritja e normave të interesit në depozita. Në mars 2023, vlera e depozitave të ekonomive familjare arriti në 3.74 miliardë euro, duke përcaktuar edhe trendin e përgjithshëm të gjithsej depozitave në sektorin bankar (grafik 28). Sa i përket nivelit të depozitave të reja të arkëtuara nga ekonomitë familjare, ku përfshihen vetëm depozitat e afatizuara, gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 arritën

Grafik 27. Stoku i gjithsej depozitave



Burimi: BQK.

Grafik 28. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje



Burimi: BQK.

vlerën prej 96.4 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 29.3 përqind, krahasuar me ritjen vjetore të vitit paraprak preee 3.5 përqind (grafik 29).

Stoku i depozitave të korporatave jofinanciare në fund të marsit 2023 arriti në 1.09 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 21.5 përqind nga 13.1 përqind në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Depozitat e reja të arkëtuara gjatë tremujorit të parë të vitit 2023 nga ky segment u rritën në 56.2 milionë euro nga 19.0 milionë deri në mars të vitit 2022. Shtrëngimi i kushteve të financimit nga masat e ndërmarra për kontrollim të inflacionit, ka ndikuar në rritjen e vazhdueshme të konkurrencës në vend për sigurimin dhe mbajtjen e depozitave; duke ofruar kushte më atraktive për depozitim të mjeteve kryesisht përmes rritjes së normave të interesit në depozita.


1.2 Normat e interesit

Normat e interesit në kredi dhe depozita të reja në vitet e fundit kishin shënuan rënie graduale, por që nga fillimi i viti të kaluar ndryshuan kahjen. Aplikimi i politikave të shtrënguara monetare nga bankat qendrore në luftën kundër inflacionit kanë krijuar ambient me shkallë të rritur të interesit, situatë që është përcjellur edhe në tregun vendor që nga gjysma e dytë e vitit 2022. Në tregun bankar normat e interesit në depozitat e reja janë ndikuar në nivel më të lartë se normat e interesit në kredi të reja. Në mars 2023, shkalla e interesit në kredi arriti në 6.3 përqind nga 5.8 përqind në mars 2022, dhe 6.0 përqind sa ishte në qershor 2022, atëherë kur inflacioni u intensifikua dhe diskutimet mbi ndërhyrjen e politikës monetare filluan. Poashtu shkalla mesatare e interesit në depozita u ngrit në 1.8 përqind nga 1.2 përqind në mars 2022 dhe 1.9 përqind në shtator 2022, atëherë kur shqetësimet mbi ruajtjen e depozitave dhe rrjedhimisht rrezikun e likuiditetit u theksuan tutje. Margjina e interesit kredi-depozitë u ngushtua në 4.5 pikë përqindje nga 4.6 pikë përqindje (grafik 30).

Dinamika e normave të interesit e ndikuar nga zhvillimet në nivel global, si dhe rritja e rrezikut të likuiditetit dhe pasigurive mbi zhvillimet në të ardhmen si pasojë e rritjes së presioneve inflacioniste, përveç që kanë shtyrë bankat në vend drejtë rritjes së normave të interesit në kredi e depozita, në të njëjtën kohë kanë ndikuar edhe në ndryshimin e strukturës së kredive sipas llojit të normave të interesit.


Përderisa në vitin 2020-2021, kreditë me shkalla variable të interesit, që kryesisht përcaktohen nga lëvizjet e normës Euribor për marzhën shtesë, përbënin mesatarisht 16.8 përqind të portfolios kreditore dhe 21.0 përqind respektivisht, kjo përbërje në mars 2023 është ngritur në 28.8 përqind (grafik 30a).

Grafik 29. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 30. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK.


Grifik 30a. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit



Burimi: BQK.


Shkalla mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare në mars 2023 qëndroi në 6.5 përqind, për 0.7 pikë përqindje më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Norma më të favorshme të interesit në kredi u ofruan për segmentin e shërbimeve (6.1 përqind), ndërsa norma mesatare më e lartë e interesit ishte për sektorin e industrisë prej 7.0 përqind (grafik 31).

Grifik 31. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare



Burimi: BQK.


Grifik 32. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Shkalla mesatare e interesit në kredi ndaj ekonomive familjare arriti në 6.0 përqind, për 0.2 pikë përqindje më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Normat më të favorshme të interesit janë aplikuar për kreditë hipotekare në mesatare prej 5.4 përqind, duke qenë se konsiderohen me rrezik më të ulët kur kanë mbulesë me kolateral (hipotekë). Kurse, kreditë konsumuese vazhdojnë të kenë norma më të larta të interesit prej mesatarisht 6.2 përqind (grafik 32). **Normat e interesit në depozita** filluan trendin rritës që nga muaji qershor i vitit 2022 duke arritur deri në mesatarisht 2.4 përqind në fund të vitit të kaluar, kurse në mars 2023 zbriti në 1.8 përqind, për 0.7 pikë përqindje më e lartë se në mars 2022. Shkalla mesatare e interesit në depozita për korporatat jofinanciare u rritën për 0.7 pikë përqindje, në 1.9 përqind, përderisa për ekonomitë familjare u rritën për 0.6 pikë përqindje, duke arritur në 1.7 përqind krahasuar me mars 2022 (grafik 33).

Grifik 33. Normat e interesit për depozita



Burimi: BQK.

Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar përmbylli tremujorin e parë të vitit 2023 me një fitim rekord neto prej 40.3 milionë euro. Rezultati i tillë financiar erdhi si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave krahas rritjes më të ngadalësuar të shpenzimeve (grafik 34).

Gjithsej të hyrat arritën vlerën prej 92.9 milionë euro në fund të tremujorit të parë të vitit 2023, që paraqet një rritje vjetore prej 13.1 përqind (12.0 përqind deri në mars 2022). Në rritjen e të hyrave kontributin kryesor kishin të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 74.4 përqind të gjithsej të hyrave. Në kuadër të të hyrave nga interesi, arkëtimet nga interesi në kredi kontribuuan kryesisht në këtë rritje, kategori e ndikuar prej rritjes së theksuar të kreditimit në dy vitet e fundit. Për më tepër, të hyrat nga investimet në letra me vlerë janë rritur theksueshëm krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Ndërsa, kategoria e të hyrave nga jo interesi, kryesisht nga tarifat dhe komisionet, shënoi rënie vjetore prej 2.6 përqind pas rritjes së theksuar prej 13.8 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën prej 20.0 milionë euro në fund të marsit 2023.


Me rritje u karakterizuan edhe shpenzimet e sektorit, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë, prej 2.2 përqind nga 7.9 përqind deri në mars të vitit të kaluar; dhe arritën vlerën prej 52.6 milionë euro në fund të marsit 2023. Kontributin më të lartë në këtë rritje kishte rritja e shpenzimeve për interesa, që arriti vlerën në 8.5 milionë euro nga 5.6 milionë euro në tremujorin e parë të vitit të kaluar. Kategoria me peshën më të madhe në gjithsej shpenzimet, ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative me pjesëmarrje prej 61.5 përqind u rritën për 5.8 përqind krahasuar me një vit më parë, dhe arritën vlerën në 32.3 milionë euro në fund të marsit 2023. Rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve të personelit, për të përshtatur nivelin e pagave me ritmin e rritjes së inflacionit që nga viti i kaluar dhe rritja e numrit të personelit krahasuar me një vit më parë (ndikuar edhe nga hyrja në treg e bankave të reja në dy vitet e fundit).

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar ndër vite ka arritur të siguroj nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit, si dhe të mbaj nivel të ulët të kredive jo-performuese. Gjendja e kënaqshme e këtyre indikatorëve i jep përparësi sektorit në absorbimin e goditjeve nga pasiguritë e shkaktuara nga krizat gjeopolitike, rritja e inflacionit dhe ngadalësimi ekonomik.

Cilësia kreditore shënoi përmirësim duke filluar nga tremujori i fundit i vitit 2021 deri në shtator të vitit të kaluar, ku vlera e kredive jo-performuese kishte trend rënës prej mesatarisht 2.5 përqind. Që nga tremujori i fundit i vitit 2022, trendi rënës ndërroi kahje, ku vlera e KJP-ve u rrit për 4.5 përqind dhe 6.0 përqind në fund të TM4 2022 përkatësisht të TM1 2023. Vlera e kredive jo-performuese për ekonominë familjare ka shënuar rritje krahasuar me një vit më parë, në 22.5 milionë euro nga 18.1 milionë euro sa ishin në fund të TM1 2022. Rritja e KJP-ve për rreth 4.3 milionë euro është si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit për këtë segment në dy vitet e fundit. Kurse, si raport ndaj kredive, KJP-të për segmentin e ekonomive familjare vazhdojnë të jenë të ulëta, prej 1.3 përqind. Vlera e KJP-ve për segmentin e korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore për vetëm 1.0 përqind krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar, duke arritur vlerën prej 65.7 milionë euro në fund të marsit 2023. Me rritje të vlerës së KJP-ve u karakterizua sektori i prodhimtarisë, që u rrit për 1.9

Grafik 34. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.

milionë euro, kurse si raport ndaj kredive u rrit për vetëm 0.1 pikë përqindje, në 1.6 përqind. KJP-të si në vlerë dhe nivel për sektorët tjerë ekonomik nuk kanë pësuar lëvizje të mëdha krahasuar me një vit më parë.

Rritja më e theksuar e kreditimit në periudhën raportuese ndikoi që raporti i përgjithshëm i kredive joperformuese të sektorit bankar të zvogëlohet në 2.0 përqind, nga 2.1 përqind në mars të vitit të kaluar. Mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kredite u zvogëluar lehtësisht në 149.1 përqind, nga 152.9 përqind në mars 2022, për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive jo-performuese se sa i vlerës së provizioneve të ndara për mbulimin e kredive (grafik 35).


Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u rrit në nivelin prej 15.7 përqind nga 15.1 përqind në mars 2022, rezultat i rritjes më të theksuar të kapitalit krahasuar me asetet me peshë rreziku. Fitimi i bartur nga viti paraprak dhe ai i realizuar në tremujorin e parë të vitit 2023 ka ndikuar që kapitali të shënoj rritje më të theksuar krahasuar me aktivitetin kreditues (që ka tendencë të rritjes më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë) (grafik 36).

Raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra shënoi rritje për 1.9 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, në 33.8 përqind në fund të marsit 2023 (grafik 37). Rritja e nivelit të likuiditetit krahasuar me një vit më parë është rezultat i rritjes së mjeteve likuide për 19.1 përqind krahasuar me rritjen e detyrimeve afatshkurtra prej 12.5 përqind Në kuadër të mjeteve likuide, investimet në letra me vlerë të qeverive të huaja shënuan rritjen më të theksuar, pasuar nga depozitat dhe plasmanët në bankat e huaja. Ndërsa detyrimet afatshkurtra janë rritur rezultat i depozitave të rritura krahasuar me mars të vitit 2022. Raporti kredi/depozitë ka zbritur në 81.1 përqind nga 82.8 përqind një vit më parë, rezultat i rritjes më të lartë të depozitave krahasuar me atë të kredive në këtë periudhë.

Sektori pensional


Asetet e sektorit pensional deri në mars 2023 shënuan ngadalësim të theksuar të rritjes krahasuar me një vit më parë, dhe kthim më të ulët në investime gjatë periudhës janar-mars 2023. Pasojë e

Grafik 35. Kredite joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione




Burimi: BQK.

Grafik 36. Treguesi i solvencës



Burimi: BQK.

Grafik 37. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.

zhvillimeve jo të favorshme makroekonomike që kanë afektuar njëkohësisht turbulencat e tregjeve financiare dhe krizës së papritur në disa banka rajonale në SHBA dhe Credit Suisse në Zvicër në mars të këtij viti, të cilat përkundër që ishin raste të izoluar, kanë ngritur shqetësimet për amplifikim të mundshëm të një krize më të gjerë financiare.


Me pjesëmarrjen e dytë më të lartë në gjithsej asetet e sistemit financiar, asetet e fondeve pensionale u rritën me 5.3 përqind në fund të marsit 2023, por që ishte dukshëm më e ngadalësuar se në vitin paraprak prej 14.0 përqind (grafik 38). Vlera e aseteve pensionale arriti në 2.47 miliardë euro, nga të cilat 99.6 përqind përfaqësohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-ja), dhe pjesa e mbetur nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP-ja). Përderisa FKPK-ja shënoi rritje vjetore të aseteve prej 5.4 përqind, asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP-ja) shënuan rënie vjetore prej 2.2 përqind në Mars 2023.

Asetete FKPK-së kryesisht janë të investuara në tregun e jashtëm (70.9 përqind e portfolios investuese), në fonde të përbashkëta në vlerë prej 1.75 miliardë euro (apo 70.8 përqind e gjithsej aseteve të FKPK-së). Pjesa tjetër e investimeve është e diversifikuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 549.8 milion euro apo 22.4 përqind e gjithsej portfolios investuese dhe certifikata të depozitit në sektorin bankar vendor në vlerë prej 128.2 milionë euro (5.2 përqind e gjithsej investimeve). Po ashtu edhe struktura e portfolios investuese e FSKP-ës është e ngjashme me atë të FKPK-së, duke qenë kryesisht e orientuar në tregun e jashtëm, në aksione që përbëjnë 69.7 përqind të portfolios investuese dhe në letra me vlerë, që përbëjnë vetëm 4.8 përqind të gjithsej investimeve. Kurse, investimet brenda vendit janë kryesisht të fokusuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës që përbëjnë 14.1 përqind të gjithsej portfolios investuese.

Që të dy fondet pensionale u karakterizuan me zvogëlim të portfolios investuese në tregun e jashtëm krahas rritjes së investimeve në atë të brendshëm, duke qenë të afektuar nga luhatjet negative që kanë prekur tregjet financiare. Në këtë kontekst për FKPK-në rritje të theksuar kishin certifikatat e depozitit dhe bilanci/paraja e gatshme me BQK-në, të cilat kategori ishin në rënie në mars të vitit paraprak, ndërsa letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës vazhduan rritjen, por me ritëm më të ngadalësuar prej 1.4 përqind nga rritja 17.5 përqind një vit më parë (grafik 38a).


Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FSKP-ja për tremujorin e parë të vitit 2023 arriti në 156.8 mijë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.7 përqind, e ndikuar nga rritja e numrit të kontribut-dhënësve. Kurse, kthimi kumulativ bruto nga investimet për tremujori e parë të vitit 2023 arriti në 247.3 mijë euro kundrejt humbjeve në vlerë 295.8 mijë një vit më parë, e që ishte rezultat i turbulencave të krijuara në tregjet financiare.

Grafik 38. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.

Grafik 38a. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



Burimi: FKPK, FSKP.

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK-ja për tremujori e parë të vitit 2023 shënoi rritje vjetore prej 18.1 përqind, duke arritur në 66.2 milionë euro. Rritja e lartë dyshifrore e kontributeve të arkëtuara ndër tjerash reflekton edhe rritjen e pagave të shërbyesëve civil, që ishte efektive nga fillimi i vitit 2023. Kurse, kthimi bruto në investime në tremujorin e parë të vitit 2023 ishte vetëm 427.5 mijë euro kundrejt humbjeve në vlerë prej 60.5 milionë euro një vit më parë. Niveli i ulët i kthimit bruto në investime në tremujorin e parë të vitit 2023 është kryesisht rezultat i luhatjeve të tregjeve globale pas dështimit të disa bankave në SHBA dhe efekteve të bartura në Evropë³. Për më tepër, tregjet financiare ende nuk janë rikuperuar nga një viti i rëndë (2022) që u karakterizua me inflacion të lartë, politika shtrënguese monetare dhe aktivitet më i dobët në ekonomitë kryesore botërore.

Sektori i sigurimeve


Sektori i sigurimeve shënoi rritje të lartë të aktivitetit për të katërtin vit me radhë; përkundër sfidave me cilat u përball sektori dhe i gjithë sistemi financiar në vend.

Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.9 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar në fund të marsit 2023. Vlera e gjithsej asetëve në fund të periudhës arriti në 289.9 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 15.5 përqind, duke vazhduar trendin e rritje dyshifrore në katër vitet e fundit (grafik 40). Zgjerimi i sektorit kryesisht erdhi si rezultat i rritjes së rezervave teknike, që burojnë nga primet e shkruara, si dhe kapitalit vetanak (kapitalit aksionar dhe fitimit të realizuar). Në kuadër të asetëve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara.

Kategoria e dytë për nga pesha, ajo e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, shënoi rritje në këtë tremujor krahasuar me gjendjen në mars 2022, por më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë, si rezultat i nivelit më të ulët të borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës


Vlera e primeve të shkruara në tremujorin e parë të vitit 2023 arriti vlerën prej 34.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.1 përqind. Rritja e primeve të shkruara reflekton kryesisht rritjen e primeve të shkruara të kategorisë ‘aksidenti dhe shëndeti’ në kuadër të sigurimit vullnetar dhe ‘përgjegjësisë motorike ndaj palës së tretë’ në kuadër të sigurimit të detyrueshëm. Primet e shkruara ndaj sigurimit të detyrueshëm vazhdojnë të kenë peshën më madhe, prej 53.2 përqind të gjithsej primeve të shkruara jo-jetë. Rritja e primeve në kuadër të sigurimit ‘aksidenti dhe shëndeti’ (për 25.8 përqind) është sinjal pozitiv për rritje të numrit të

Grafik 39. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK.

Grafik 40. Asetet e sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK.

³ Blerjes së Credit Suisse nga UBS, të dy këto banka me rëndësi të përgjithshme sistemit në nivel global

qytetarëve që posedojnë sigurim shëndetësor. Përderisa, rritja e primeve të sigurimit të detyrueshëm reflekton kryesisht kategorinë e 'sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjesisë - MTPL', që shënuan rritje për 10.2 përqind.

Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve në tremujorin e parë të vitit 2023 arriti vlerën prej 19.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 35.0 përqind (-0.5 përqind një vit më parë) (grafik 41). Vlera e dëmeve të paguara nga BKS-ja ka shënuar rënie prej 31.9 përqind, kurse dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 48.0 përqind. Rritja e theksuar e dëmeve të paguara buroi nga segmenti 'jo-jetë', përkatësisht dëmeve të 'sigurimit nga zjarri dhe forcat e natyrës' dhe 'përgjegjesisë motorike ndaj palës së tretë - MTPL'. Sektori i sigurimeve në tremujorin e parë të vitit 2023 realizoi fitim në vlerë prej 2.3 milionë euro (0.4 milion euro në periudhën e njëjtë të një viti më parë). Vlera më e lartë e fitimit të realizuar kundrejt vitit të kaluar erdhi si rezultat i vlerës më të lartë të hyrave të arkëtuara nga primet e shkruara krahasuar me vlerën e shpenzimeve për dëmet të paguara.

Grafik 41. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.


Sektori mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar në tremujorin e parë të vitit 2023 shënoi rritje të përshpejtuar të asetëve, kryesisht ndikuar nga zgjerimi i kreditimit dhe lizingjeve, që u financuan nga huatë e marra nga sektori i jashtëm dhe kapitali vetanak. Rezultati financiar ishte i ngjashëm me atë të vitit të kaluar kurse indikatorët e cilësisë së portfolios kreditore vazhdojnë të jenë në nivele optimale. Sidoqoftë, sektori mund të përballet me kosto të rritura të financimit për shkak të rritjes së normave të përgjithshme të interesit si rezultat i politikave të shtrënguara monetare të aplikuara nga shumë banka qendrore për kontrollim të inflacionit. Këto dinamika, mund të reflektohen në rritje tutje të normave të interesit për kredi, për shkak të varësisë së madhe në financim të aktivitetit nga huatë e jashtme (60.7 përqind të detyrimeve dhe kapitalit).

Asetet

Asetet e sektorit mikrofinanciar shënuan rritje të përshpejtuar vjetore prej 18.0 përqind në mars 2023, duke arritur vlerën prej 419.0 milionë euro në fund të periudhës (grafik 42). Në këtë rritje kontributin kryesor e kishte rritja e kreditimit dhe në masë më të ulët rritja e lizingjeve. Aktiviteti kreditor i sektorit vazhdon të mbështetet nga huazimet (linjat kreditore) jashtë vendit të cilat u rritën për 17.1 përqind. Po ashtu, kontribut në rritjen e aktivitetit të sektorit kishte edhe rritja e nivelit të kapitalit, kryesisht përmes fitimit të bartur ndër vite dhe atij të realizuar deri në mars të vitit 2023.

Grafik 42. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Kreditë

Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar vazhdoi të rritet me ritëm të përshpejtuar për të dytin vit me radhë, duke arritur trendin e para pandemisë (2016-2019).


Gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar shënuan rritje vjetore për 22.2 përqind në fund të marsit 2023, përdërisa stoku i tyre arriti në 304.0 milionë euro. Kreditimi u rrit për të dy segmentet e sektorit privat, korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare. Konkretisht, kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 19.2 përqind (rritje vjetore prej 17.1 përqind në vitin 2022), duke arritur vlerën 192.1 milionë euro në fund të marsit 2023 (grafik 43). Stoku i kredive ndaj korporatave jo financiare arriti vlerën prej 111.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 27.9 përqind (rritje për 22.5 përqind në mars 2022).

Grafik 43. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare




Burimi: BQK.

Grafik 44. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.


Grafik 45. Kontributi në rritje të kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.

Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare sipas sektorëve të ekonomisë ka ndjekur trendin rritës, duke shënuar rritje në secilin sektor ekonomik (grafik 44). Për dallim nga sektori bankar, stoku i kredive ndaj segmentit të bujqësisë ka peshën më të madhe në gjithsej kreditimin e korporatave jofinanciare të IMF/IFJB-ve, prej 25.6 përqind. Për më tepër, ky segment kishte kontributin e dytë më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit ndaj korporatave jofinanciare (grafik 45), duke shënuar rritje vjetore prej 26.8 përqind në mars 2023 dhe arritur vlerën prej 28.7 milionë euro. Në rritjen e kreditimit për segmentin e bujqësisë ndikim kishte edhe garancioni kreditr i ofruar nga FKGK-ja për të mbuluar rrezikun për kreditë në sektorin Agro për NMVM-të. Krahasuar me një vit më parë, shuma e miratuar e kredive nga FKGK-ja arriti në 537.4 milionë euro,

Grafik 46. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

apo për 23.1 përqind më shumë se një vit më parë. Si rrjedhojë e kredive të garantuara prej FKKG-së, institucionet mikrofinanciare i janë përgjigjur pozitivisht kërkesë për kredi për këtë sektor që ka rrezik më të lartë, për shkak të varshmërisë së lartë ndaj kushteve klimatike dhe rreziqeve natyrore. Po ashtu, me rritje dyshifrore gjatë kësaj periudhe u karakterizuan edhe segmenti i industrisë, ndërtimitarisë dhe tregtisë, kurse kreditimi ndaj segmentit të shërbimeve tjera, kishte kontributin dhe rritjen më të lartë gjatë kësaj periudhe

Lizingjet

Lizingjet vazhdojnë të jenë kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar (17.8 përqind). Aktiviteti i lizingjeve për të dytin vit me radhë shënoi rritje dyshifrore, dhe arritën vlerën në 74.5 milionë euro në fund të marsit 2023 (grafik 46). Në rritjen e lizingjeve kontributin kryesor vazhdojnë të kenë korporatat jofinanciare, përdërisa kontributi i lizingjeve për ekonomitë familjare ishte më i limituar.


Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga ky sektor në mars 2023 ishte 19.4 përqind, për 0.5 pikë përqindje më e lartë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 47). Për dallim nga sektori bankar, që ka shkalla pothuajse trefish më të ulëta për shkak të kostos së ulët të financimit të aktiviteteve (përmes depozitave), IMF/IFJB-të kryesisht financohen nga kreditë e marra nga sektori i jashtëm, që kanë norma më të larta të interesit. Zhvillimet e fundit në sektorin financiar, përkatësisht rritja e normave bazë të interesit nga bankat qendrore, pritet të reflektohet në koston e financimit të sektorit dhe potencialisht, të përkthehet në rritje tutje të normës së interesit në kredi të ofruar nga ky sektor.

Norma e interesit për kreditë e ekonomive familjare shënoi rritje për 1.0 pikë përqindje, në 21.8 përqind. Sipas llojit të kredive, norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese u rrit për 0.4 pikë përqindje në 23.0 përqind. Kurse, kreditë hipotekare vazhdojnë të kenë normat më të ulëta të interesit, në mesatare prej 19.5 përqind në marsi 2023, por që krahasuar me vitin e kaluar shënoi rritje të theksuar, prej 3.1 pikë përqindje.


Për korporatat jofinanciare, normat mesatare të interesit, u zvogëluan pothuajse për të gjitha veprimtaritë ekonomike (grafik 48). Shkalla e interesit për kreditë për sektorin e bujqësisë dhe atë të industrisë u zvogëluan për 0.9 dhe 2.9 pikë përqindje përkatësisht, duke qëndruar në 18.0 përqind dhe 17.7 përqind respektivisht në fund të marsit 2023. Kurse, kreditë ndaj sektorit të shërbimeve, që kanë kushtet më të favorshme të interesit, në fund të marsit 2023 kishin normë të interesit prej 14.6 përqind, rritje vjetore prej 0.9 pikë përqindje.

Grafik 47. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Grafik 48. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

Performanca e sektorit mikrofinanciar


Sektori mikrofinanciar në tremujorin e parë të vitit 2023 arriti të ruaj nivelin e profitabilitetit të periudhës së njëjtë të një viti më parë, pavarësisht që sektori u përball me rritje të kostos së financimit të aktiviteteve të saj. Në fund të marsit 2023, ky sektor shënoi fitim neto në vlerë prej 4.1 milionë euro, ngjashëm me gjendjen në fund të marsit të vitit të kaluar (grafik 49).

Rritja më e theksuar e shpenzimeve për 23.6 përqind, krahasuar me rritjen më të ulët të hyrave për 16.6 përqind, ndikuan që sektori të arrij të ruaj nivelin e fitimeve të vitit të kaluar, por duke pamundësuar zgjerimin e marzhës së fitimit.

Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi, që paraqesin kategorinë dominues të të hyrave (91.6 përqind), shënuan rritje vjetore prej 16.6 përqind (ngjashëm edhe në tremujorin e parë të vitit 2022), si rezultat i rritjes së theksuar të kreditimit në dy vitet e fundit. Kategoria e të ardhurave nga jointerеси në tremujorin e parë të vitit 2023 shënoi rritje vjetore prej 16.6 përqind (13.6 përqind një vit më parë), por që kontributi i tyre në rritjen e gjithsej të hyrave ishte i limituar për shkak të peshës së ulët në gjithsej të hyrat (pjesëmarrje prej 8.4 përqind).


Në kuadër të shpenzimeve, rritja kryesisht i'u atribuua shpenzimeve të personalit dhe administrative. Kjo nënkategori shënoi rritje vjetore prej 16.6 përqind (20.8 përqind një vit më parë), që mund ti atribuohet rritjes së shpenzimeve për paga të punëtorëve në korrigjim me inflacionin, dhe në masë më të ulët atyre administrative. Për më tepër, rritja e numrit të personelit si dhe rritja e pagave për të korrigjuar inflacionin në rritje, kanë kontribuar në rritje të kësaj nënkategorie të shpenzimeve të jointerесit, kostot e së cilës janë bartur në tremujorin e parë të vitit 2023. Ndërsa, kategoria e shpenzimeve të interesit (23.5 përqind të gjithsej shpenzimeve) shënoi rritje vjetore prej 35.2 përqind në fund të marsit 2023 (-3.6 përqind një vit më parë), duke reflektuar rritjen e nivelit të huazimeve prej sektorit të jashtëm, si dhe rritjes së kostos së financimit nga rritja e normave të interesit. Niveli i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive mbetet i ulët dhe është zvogëluar tutje për 0.5 pikë përqindje, në 1.8 përqind. Përderisa, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në mars 2023 është rritur në 152.1 përqind (143.5 përqind në mars 2022) (grafik 50).

Grafik 49. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Grafik 50. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore




Burimi: BQK.

Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës

Emetimi i letrave me vlerë qeveritare deri në mars 2023 ishte dukshëm më i ulët se në periudhën e njëjtë të një viti më parë, përderisa kërkesa për të investuar në letra me vlerë ka vazhduar të tejkalojë ofertën e qeverisë.


Grafik 51. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.


Deri në mars të vitit 2023, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 51.8 milionë euro, për 13.4 përqind më pak se një vit më parë (grafik 51). Ndërsa, kërkesa për të investuar, në mungesë të alternativave investuese për diversifikim të mjeteve, vazhdimisht ka tejkaluar ofertën. Kërkesa për letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte për 1.66 herë më e lartë se sa shuma e ofruar nga Qeveria, ndërsa në vitin paraprak ishte për 1.37 herë më e lartë (grafik 51a). Investuesit kryesor në borxhin e qeverisë të Kosovës në formë të letrave me vlerë janë fondet pensionale, që këtë vit kanë rritur pjesëmarrjen në gjithsej borxhin e qeverisë në 64.1 përqind nga 62.5 përqind në mars të vitit 2022, ndërsa bankat komerciale kanë zvogëluar pjesëmarrjen në 30.4 përqind nga 32.7 përqind në vitin e kaluar. Deri në mars 2023, stoku i letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës të mbajtur nga bankat, pensionet dhe sigurimet arriti vlerën në 859.2 milionë euro (873.3 milionë euro në mars të vitit të kaluar). Struktura e letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës ndër vite ka pësuar ndryshime graduale drejt emetimit të letrave me vlerë me afat më të gjatë maturimit. Në periudhën janar-mars 2023, struktura u dominua me 48.3 përqind nga fletë-obligacionet qeveritare me maturitet prej '5 viteve', për dallim nga viti paraprak ku emetimi i fletë-obligacioneve me maturitet prej '3 viteve' kishte pjesëmarrje prej 41.8 përqind (grafik 52).

Grafik 51a. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 52. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 42, TM1 2023, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK:

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

ASK:

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

Të tjera:

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org)

Euribor: Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

ECB (BQE): Economic Bulletin Research & Publications (europa.eu)

IMF (FMN): World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](http://imf.org)

World Bank: Commodity Markets: [Commodity Markets \(worldbank.org\)](http://worldbank.org)



Rr. Garibaldi, nr. 33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org